



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT**

AN230120210002

Tiranë, më: 16.03.2021

Vendimi 13

**DEKLARATE MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

**Lëshimin e Deklaratës Mjedisore negative, për Zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:**

**Personi Juridik:** “KRONOS KONSTRUKSION” Sh.p.k.

**Nr. NIPT-i:** K41416033P

**Adresa e selisë:** Bulevardi “Gjergj Fishta”, Prane Ish Ekspozites Shqiperia Sot, Tirane,

**Personi përgjegjës:** Vasil Jovani

**Për të zhvilluar projektin “Shfrytëzimi i gurit gelqeror me karriere sipërfaqesore" me leje minerare për zonën minerare nr. 122/9 për shfrytëzimin e gurit gëlqeror në objektin Mali i Pashkasheshi”**

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqesore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** Zona Kadastrale: 2145, Nr. Pasurisë: 111, Mali i Pashkasheshit, Tiranë.  
(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr.10440, date 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

*Refuzimi i kërkesës për leje/licencë zhvillimi për atë projekt, për shkak të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse*

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr.10440, datë: 7.7.2011, "Për vlerësimin ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshte po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:**

*Drejtoritë teknike të ministries shprehin mendimin si më poshtë vijon:*

- **Objekti ndodhet pranë monumentit të natyrës, Shpellës së Pëllumbasit, miratuar me Vendim Nr.303, datë 10.5.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve.**
- **Gjithashtu, ndodhet dhe shumë afër me zonën e mbrojtur të Parkut Kombëtar të Malit të Dajtit.**
- **Theksojmë se rreth gurores ka shtëpi banimi të cilat janë shumë afër me objektin që kërkon zgjerim, si dhe rruga egzistuese e cila përshkruhet nga makineritë e rënda është e shkatërruar plotësisht, kjo është e vetmja rrugë e cila të çon në destinacionin turistik dhe pranë monumentit të natyrës së Shpellës së Pëllumbasit.**

### **Konstatohet se:**

- nuk përshkruhet përdorimi aktual i sipërfaqes që do të përdoret për projektin, (e përshkruan sipërfaqen pa mbulesë bimore ndërsa fotot tregojnë të kundërtën).
- nuk jepen treguesit kadastrale të sipërfaqes pyjore që do të përdoret për aktivitetin.
- nuk jepet baza ligjore institucionale dhe marrja e informacionit për pyjet.
- nuk jepen të dhëna konkrete për vlerat e ndikuara që përfshihen në projekt, sidomos në lidhje me zonat e mbrojtura mjedisore, largësinë nga to dhe analizën e ndikimit.
- nuk jepet qartë si do ndikojë aktiviteti në mjedis (si do ishte mjedisi pa projektin), çfarë ndodh pas projektit, si mund të jetë mjedisi pas rehabilitimit.
- nuk jepen masat e mundëshme konkrete për shmangien/zbutjen e ndikimeve negative, nuk jepen dhe nuk parashtron lidhjen me projektet e tjera në zonë, sidomos të këtij karakteri (gurore).
- nuk parashikon masa paraprake për shmangien dhe shuarjen e zjarreve në rastet e aksidenteve gjatë plasjes së lëndëve.

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Subjekti “Kronos Konstruksion” sh.p.k, kërkon të zhvillojë aktivitetin “Shfrytëzim i mineralit gurë gëlqërorë”, zona minerare 122/9, në objektin Mali i Pashkasheshit, me vendodhje fshati Pashkashesh, njësia administrative Bërzhitë, qarku Tiranë.*

**Referuar Raportit e Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe koordinatave të paraqitura nga subjekti, rezulton sipërfaqja (zona), ku do të kryhet aktiviteti, ndodhet në MN “Gryka e Murdharit”, shpallur më VKM-në nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”, të rishpallur me VKM-në nr. 303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar të monumenteve të natyrës Shqiptare”, kategoria e III e zonave të mbrojtura. Gjithashtu fakti që aktiviteti do të zhvillohet në një monument natyror, nuk shprehet fare në Raportin e VNM-së. Bazuar në ligjin nr. 81, datë 04.05.2017, neni 17, pika 2 dhe 3 citohet se: “Në një “Monument natyre” zbatohet shkalla e mbrojtjes, e njëjtë me “Rezervën strikte”.**

Zona mbrohet e menaxhohet për ruajtjen e karakteristikave dhe dukurive të veçanta natyrore, kulturore, historike e arkeologjike, për të cilat është shpallur monument”. “Monumentet natyrore rrethohen nga zona buferike me gjerësi deri në 200 metra nga perimetri i monumentit”.

**Përsa më sipër, shprehemi kundër zhvillimit të këtij aktiviteti në pozicionin e kërkuar.**

*Agjencia Rajonale e Mjedisit Tirane Durrës Diber shprehet:* Shqyrtimi i dosjes nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër është bërë në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit e-lege në pamundësi të verifikimit në vend nga ana e specialistëve të agjencisë.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër jep mendimin e saj pozitiv në lidhje me praktikën

**2. Ministria ka marrë në shqyrtim mendimet e shprehura nga publiku dhe institucionet përkatëse, si dhe shkallën e reflektimit të tyre;**

**3. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitorëve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

**4. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:**

- Mendimin e **Agjencise Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.**
- Objekti ndodhet pranë monumentit të natyrës “Syri i Ciklopit” i cila konsiderohet pike strategjike për zhvillimin e turizmit të zonës.
- Gjithashtu, ndodhet dhe shumë afër me zonën e mbrojtur të Parkut Kombëtar të Malit të Dajtit.
- Shkaktohet ndotje vizuale për zhvillimin e turizmit të zonës.
- Nuk janë plotësuar kërkesat në bazë të Urdhrit Nr.67 datë 11.03.2018 “Për miratimin e Planit të Veprimtimit për veprimtaritë minerare me karrierë (guroret).
- Nuk jepen masat që janë marrë lidhur me rehabilitimin e sipërfaqes së shfrytëzuar deri tani.
- Në raportin e thelluar të VNM-së subjekti nuk ka mbajtur parasysh të gjitha sugjerimet e bëra në fazën e njoftimit për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së sa i takon menaxhimin të mbetjeve që do të gjenerohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.

- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, nuk janë përshkruar masat konkrete i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**

**EDISON KONOMI**

**MINISTRI**

**BLENDI KLOSI**

*Konceptoi:*

*Miratoi:*

1. Anex 1.Harta dhe koordinat

